



VENDIM
Nr. 575, datë 22.7.2026

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, TË
PROCEDURAVE E TË MASËS SË
KOMPENSIMIT NË RASTET E
PLAGOSJES DHE DËMTIMIT TË
SHËNDETIT TË PUNONJËSVE TË
POLICISË SË SHETIT, SI DHE PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE E TË
PROCEDURËS SË TRAJTIMIT TË
FAMILJARËVE TË PUNONJËSVE TË
POLICISË SË SHETIT QË HUMBIN
JETËN PËR SHKAK TË DETYRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 108, pika 2, e 111, pika 2, të ligjit nr. 82/2024, “Për Policinë e Shtetit”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka objekt përcaktimin e rregullave, të procedurave e të masës së kompensimit në rastet e plagosjes dhe dëmtimit të shëndetit të punonjësve të Policisë së Shtetit, si dhe përcaktimin e rregullave e të procedurës së trajtimit të familjarëve të punonjësve të Policisë së Shtetit që humbin jetën për shkak të detyrës.

2. Në kuptim të këtij vendimi, me pjesëtar të familjes së punonjësit të Policisë së Shtetit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, do të kuptojmë personat, sipas përbërjes së certifikatës familjare të punonjësit të Policisë së Shtetit, në momentin e humbjes së jetës për shkak të detyrës.

3. Trajtimi financiar që pjesëtarët e familjes së punonjësit të Policisë së Shtetit përfitojnë, në bazë të rregullave dhe të procedurave të përcaktuara në këtë vendim, zbatohet pa krijuar mbivendosje me ndonjë përfitim të mundshëm financiar, sipas parashikimeve të akteve të tjera ligjore dhe nënligjore.

II. NDIHMA E MENJËHERSHME FINANCIARE

1. Pjesëtarët e familjes së punonjësit të Policisë së Shtetit, që jetonin me punonjës në policisë në kohën e humbjes së jetës, për shkak të detyrës, përfitojnë deri në 10 (dhjetë) paga mujore bruto, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie

shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune, referuar pagës mujore bruto të muajit të fundit.

2. Në rastet kur punonjësi humb jetën jashtë shërbimit, kërkesa për përfitimin e ndihmës së menjëhershme mund të paraqitet nga çdo anëtar madhor i familjes.

3. Për t’u trajtuar me ndihmë të menjëhershme financiare, strukturat e burimeve njerëzore në njësitë shpenzuese në Policinë e Shtetit paraqesin për shqyrtim në komisionin përkatës, të ngritur me urdhr të ministrit të Punëve të Brendshme, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Procesverbalin e referimit të rrethanave të ngjarjes, në të cilat ka humbur jetën punonjësi, nga strukturat përkatëse;

b) Certifikatën familjare;

c) Certifikatën e vdekjes së punonjësit të Policisë së Shtetit;

ç) Dokument identifikimi për personin që kërkon përfitimin e trajtimit të menjëhershëm financiar;

d) Një deklaratë të familjarëve madhorë të punonjësit të Policisë së Shtetit që ka humbur jetën për shkak të detyrës, ku shprehin dakordësinë që pagesa të bëhet në emër të kërkuesit, për llogari të të gjithë familjarëve;

dh) Vendimin apo vërtetimin, ku prokuroria/gjykata shprehet për shkakun e humbjes së jetës;

e) Vërtetimin e llogarisë bankare ku do të kreditohen fondet e ndihmës së menjëhershme financiare.

4. Ndihma e menjëhershme financiare përballohet nga buxheti i njësisë shpenzuese në Policinë e Shtetit, sipas dokumentacionit përkatës.

III. ORGANIZIMI I CEREMONISË MORTORE

1. Pas vërtetimit të ndarjes nga jeta të punonjësit të Policisë së Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit siguron organizimin e një ceremonie mortore solemne.

2. Planifikimi dhe koordinimi i aktiviteteve lidhur me ceremoninë mortore bëhet në bashkëpunim me një pjesëtar të familjes, kur kjo kërkohet nga pjesëtarët e familjes.

3. Shpenzimet e varrimit vërtetohen, sipas dokumentacionit, si më poshtë vijon:

a) kërkesës për miratim të shpenzimeve;

b) faturës tatimore të shpenzimeve për organizimin e ceremonisë mortore;



c) urdhrit për pagesën e shpenzimeve të ceremonisë mortore.

4. Shpenzimet e shërbimit të varrimit përballohen nga buxheti i njësisë shpenzuese në Policinë e Shtetit, sipas dokumentacionit përkatës.

IV. NDIHMA FINANCIARE NË DITËN PËRKUJTIMORE

1. Pjesëtarët e familjes së punonjësit të Policisë së Shtetit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, çdo përvjetor përfitojnë ndihmë financiare, në masën e një page mujore referuese, e njësuar si pagë mujore bruto, në kohën e dhënies së kësaj pagese.

2. Paga mujore referuese e punonjësit të Policisë së Shtetit përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune që kishte punonjësi, e cila njësohet si pagë mujore bruto, në kohën e dhënies së kësaj pagese.

3. Dhënia e ndihmës financiare në ditën përkujtimore përballohet nga buxheti i miratuar i njësisë shpenzuese në Policinë e Shtetit.

V. PENSIONI FAMILJAR SUPLEMENTAR

Pjesëtarët e familjes së punonjësit të Policisë së Shtetit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, përfitojnë pension suplementar familjar, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në ligjin nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

VI. TRAJTIMI ME BURSË PËR SHKOLLIM

Fëmijët e punonjësit të Policisë së Shtetit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, përfitojnë trajtimin me bursë të plotë për shkollim në arsimin parauniversitar dhe atë të lartë, sipas përcaktimeve dhe procedurave për dhënien e tyre në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar dhe arsimin e lartë.

VII. TRAJTIMI ME BANESË FALAS I FAMILJARËVE

1. Bashkëshorti/ja dhe fëmijët e punonjësit të Policisë së Shtetit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, kur janë të pastrehë, përfitojnë falas:

a) banesa të ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave;

b) banesa të siguruara në zbatim të projekteve të investimit të Korporatës së Investimeve Shqiptare, për të cilat me vendim të Këshillit të Ministrave, vihet në dispozicion si pasuri e paluajtshme shtetërore në administrim/pronësi të ministritë përgjegjëse për rendin dhe sigurinë apo entiteteve të tjera publike dhe autorizohet Korporata për shkëmbimin/kompensimin/ transferimin e pjesës takuese të saj për realizimin e qëllimit/ nevojës publike;

c) banesa të konfiskuara, sipas legjislacionit në fuqi për konfiskimin e pasurive nga krimi i organizuar ose të konfiskuara nga ndërtimet pa leje ose në tejkalim të lejes së ndërtimit;

ç) banesa të blera, sipas çmimit të tregut nga Policia e Shtetit, nga buxheti i miratuar i Policisë së Shtetit.

2. Banesa transferohet pa kundërshtpërblim, në bashkëpronësi të familjarëve të punonjësit të Policisë së Shtetit. Pronësia nuk mund të transferohet nga përfituesit, sipas formave të parashikuara në Kodin Civil në periudhën që familja përfituese ka fëmijë minorene, dhe, në çdo rast, jo më herët se 5 vjet nga marrja në pronësi. Kontrata e kalimit të pronësisë lidhet nga enti administrues i pasurisë, sipas vendimit të komisionit në Policinë e Shtetit.

3. Kërkesa për të përfituar banesën falas paraqitet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit nga personi madhor, që ka të drejtën e përfitimit, dhe shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokument identifikimi për personin/personat që kërkon/jnë përfitimin e banesës falas;

b) Certifikatën familjare të muajit të fundit para se punonjësi i Policisë së Shtetit të ketë humbur jetën në krye të detyrës;

c) Certifikatën e vdekjes së punonjësit;

ç) Vendimin përfundimtar nga institucionet e drejtësisë ku provohet humbja e jetës për shkak të detyrës dhe nëse nuk ka një vendim përfundimtar, procesverbalin e referimit nga strukturat përkatëse të rrethanave të ngjarjes, në të cilat ka humbur jetën punonjësi;

d) Informacion nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës që nuk ka banesë në pronësi ose në proces legalizimi, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për secilin person që ka të drejtën e përfitimit, për të gjithë personat në përbërje familjare të tij dhe se nuk ka pasur banesë kur ka humbur jetën punonjësi i policisë;



dh) Vërtetimin që nuk është aktualisht përfitues nga programet e strehimit social.

4. Për shqyrtimin e kërkesës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit ngrihet një komision, i cili kryesohet nga zëvendësdrejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit. Komisioni merr vendim për pranimin ose jo të kërkesës, brenda 1 (një) muaji nga momenti i paraqitjes së dokumentacionit të plotë. Komisioni, nëse e konstaton të nevojshme, i kërkon kërkuarit plotësimin e dokumentacionit dhe sqarime mbi dokumentacionin e paraqitur. Në çdo rast, arsyetohet vendimarrja.

5. Në vendimin e komisionit përcaktohen personat që përfitojnë banesën, struktura dhe sipërfaqja takuese e apartamentit, sipas aneksit nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

6. Vendimi i komisionit përcillet nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit pranë Entit Kombëtar të Banesave, Korporatës së Investimeve Shqiptare, Komisionit të Objekteve të Konfiskuara dhe Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara për të vënë në dispozicion banesat e disponueshme që mund të përdoren për trajtimin e familjarëve.

7. Bashkëshortit/bashkëshortes dhe fëmijëve të punonjësit të Policisë së Shtetit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, deri në përfitimin falas të strehimit, iu kompensohet qiraja e banesës, sipas vlerës së përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave, që përcakton vlerën minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave.

VIII. PUNËSIMI

1. Ministria e Punëve të Brendshme, brenda limitit organik, trajton me prioritet kërkesën për punësim, brenda sistemit të ministrisë, të pjesëtarit të familjes së punonjësit të Policisë së Shtetit që ka humbur jetën për shkak të detyrës, në përputhje me arsimimin, përvojën dhe kriteret e tjera, të përcaktuara për vendin e punës.

2. Pjesëtari i familjes, që kërkon të punësohet, dorëzon kërkesën pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, duke specifikuar vendin e punës për të cilin shpreh interesin, duke dorëzuar të gjithë dokumentacionin shoqërues për të vërtetuar përvojën dhe kriteret e tjera të nevojshme për vendin e punës.

3. Kërkesat për punësim prioritar, sipas pikave 1 dhe 2, të këtij kreu, administrohen nga struktura e

burimeve njerëzore e ministrisë, e cila verifikon plotësimin e kriterit të përvojës dhe kriterëve të tjera të nevojshme, si dhe i kërkon kërkuarit të plotësojë dokumentacionin provues për kriteret, brenda një afati të arsyeshëm.

4. Në rastet kur ministria është në pamundësi për të sistemuar me punë familjarin e punonjësit të Policisë së Shtetit, që ka humbur jetën për shkak të detyrës, në vendin e kërkuar prej tij ose kur në kërkesën për punësim prioritar nuk ka shprehje interesi për një vend pune të caktuar, kërkesa, e shoqëruar me jetëshkrimin e kërkuarit, i përcillet Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.

IX. KOMPENSIMI NË RASTET E PLAGOSJES DHE DËMTIMIT TË SHËNDETIT TË PUNONJËSVE TË POLICISË GJATË OSE PËR SHKAK TË DETYRËS

1. Punonjësi i Policisë së Shtetit, që plagoset apo dëmtohet gjatë apo për shkak të detyrës, kompensohet deri në 8 (tetë) paga mujore për të dëmtuarit rëndë dhe deri në 4 (katër) paga mujore për të plagosurit dhe të dëmtuarit lehtë, e cila përbëhet nga paga për gradë, shtesa për çdo vit vjetërsie shërbimi dhe shtesa për natyrë të veçantë pune, referuar pagës mujore bruto të muajit të fundit.

2. Për të përfituar kompensim financiar, sipas pikës 1 të këtij kreu, strukturat e burimeve njerëzore në njësitë shpenzuese, paraqesin për shqyrtim në komisionin përkatës, të ngritur me urdhër të ministrit të Punëve të Brendshme, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Procesverbalin e referimit nga strukturat përkatëse të rrethanave të ngjarjes;

b) Vendimin apo vërtetimin, ku prokuroria/gjykata shprehet për shkakun e plagosjes apo dëmtimit të shëndetit;

c) Aktin që kategorizon plagosjen, si të lehtë apo të rëndë nga Instituti i Mjekësisë Ligjore;

ç) Certifikatën familjare;

d) Dokumentin e identitetit të personit që kërkon përfitimin.

3. Punonjësi i Policisë së Shtetit, që plagoset apo dëmtohet gjatë apo për shkak të detyrës dhe deklarohet i paafte për punë nga komisioni kompetent mjekësor, përfiton çdo muaj kompensim financiar, në masën e pagës mujore bruto të muajit të fundit.

4. Për të përfituar kompensim financiar, sipas pikës 3 të këtij kreu, struktura e burimeve njerëzore



në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, përveç administrimit të dokumentacionit dhe vendimit të komisionit, sipas pikës 2, të këtij kreu, administron edhe vendimin e komisionit kompetent mjekësor për deklarimin e paaftësisë për punë. Kompensimi financiar vazhdon deri në rehabilitimin e aftësive shëndetësore për t'u paraqitur në punë.

X. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, planifikohen dhe përballohen nga buxheti i miratuar për programin buxhetor “Policia e Shtetit” për vitin përkatës.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, sipas kreut V, planifikohen dhe përballohen nga buxheti i miratuar i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 552, datë 27.11.1999, “Për trajtimin ekonomik e financiar të familjeve të punonjësve të policisë që humbin jetën ose plagosen për shkak të detyrës”, të ndryshuar, dhe nr. 563, datë 13.10.2001, “Për dhënie ndihme të menjëhershme për përballimin e shpenzimeve të shërbimit të varrimit”, të ndryshuar, shfuqizohen. Trajtimet e dhëna, sipas këtyre vendimeve zbatohen deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministria e Arsimit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Enti Kombëtar i Banesave, Korporata e Investimeve Shqiptare, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi

ANEKSI 1

SIPËRFAQJA E BANESËS QË PËRFITOHET NGA FAMILJARËT

Tipi i njësive së banimit	Numri i anëtarëve të familjes përfituese	Sipërfaqe neto në metër katror	
		Minimale	Maksimale
Studio	1-2	30	45
1+1	2	40	55
2+1	3-4	50	81
3+1	4-6	60	100

VENDIM

Nr. 576, datë 22.7.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 723, DATË 19.11.1998, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 7889, DATË 14.12.1994, PËR STATUSIN E INVALIDIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 3, e vendimit nr. 723, datë 19.11.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin e ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Shuma mujore e rimbursimit të shpenzimeve për blerjen e karburanteve e të lubrifikanteve është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë.”.

2. Efektet financiare, në masën 27 000 000 (njëzet e shtatë milionë) lekë në vit, për zbatimin e këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit dhe programohen çdo vit në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçi